




REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-D/DPK
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	04
Nr. Prot. Bi Prot. Prot No	01-3891/14
Date Datum Date	31.10-2014
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY**

DATË/A:	31.10.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Nazmie PAÇARIZ Menaxhere e Zyrës së Prokurimit – Spitali i Përgjithshëm " Prim. Dr. Daut Mustafa në Prizren "
CC:	z. Afrim AVDAJ Drejtor Ekzekutiv - Spitali i Përgjithshëm " Prim. Dr. Daut Mustafa në Prizren "
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me tenderin me titull " Blerja e Pajisjeve mjekësore "

E nderuara znj. Paçariz ,

Duke u bazuar në nenin 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit për Agjencinë kundër Korrupsionit nr.03/L-159 dhe nenin 19 paragrafi 1, nën paragrafi 1.6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me tenderin me titull " Blerja e Pajisjeve mjekësore " me numër prokurimi: 70300-14-079-121, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Blerja e Pajisjeve mjekësore " me numër prokurimi: 70300-14-079-121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

Arsyetime

Zyra e Prokurimit në Spitalin e Përgjithshëm në Prizren ka përgatitë njoftimin për kontratë me titull "*Blerja e Pajisjeve mjekësore*" me numër prokurimi:70300-14-079-121, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me datë: 15.09.2014, në Procedurën e Hapur. Agjencia kundër Korrupsionit, përmes Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik, ka trajtuar këtë procedurë të prokurimit, ku gjatë trajtimit dhe ekzaminimit të dokumentacionit të dosjes së tenderit ka hasur në disa të dhëna që bien ndesh me dispozitat e Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Agjencia kundër Korrupsionit me dt.30.09.2014 ka paraqitur kërkesë zyrtare pranë Autoritetit kontraktues, përmes së cilës ka kërkuar që ti ofrohet dokumentacioni i nevojshëm për këtë procedurë të prokurimit, pasi Autoriteti të përfundoj me procesin e vlerësimit të tenderëve dhe para se A.K. të bëjë Njoftimin për dhënie të Kontratës. Agjencia, pasi ka pranuar dokumentacionin e kërkuar ka ekzaminuar dhe shqyrtuar me kujdes dokumentet e pranura për këtë aktivitet të prokurimit ka konstatuar faktet si në vijim:

Gjatë ekzaminimit të dokumentacionit lidhur me këtë procedurë të prokurimit, Agjencia kundër Korrupsionit konstaton se Autoriteti Kontraktues ka bërë ndarjen e këtij aktiviteti të prokurimit në **5 lote (pjesë)** ku Dosjen e Tenderit e kanë tërhequr **24 Operator Ekonomik** ku **11** prej tyre i kanë dorëzuar ofertat për lotët si në vijim: Për lot 1 ofertat i kanë dorëzuar 2 Operator Ekonomik, për lot 2 ofertat i kanë dorëzuar 5 Operator, për lot 3 ofertat i kanë dorëzuar 4 Operator Ekonomik, ndërsa lotin 4 ofertat e tyre i kanë dorëzuar 6 Operator Ekonomik dhe për lot 5 ka pasur vetëm 1 ofertë.

Agjencia, pasi ka ekzaminuar me kujdes ofertat për lot 1 ka konstatuar faktet si në vijim: për këtë lot ka pasur 2 oferta ku Operatori ekonomik i renditur me nr. 1 në Raportin e vlerësimit të Tenderëve ka ofruar Autorizim origjinal direkt nga prodhuesi për shitje dhe servisim, ndërsa Operatori tjetër i cili ka ofertuar për këtë lot ka pasur Autorizim nga Operatori ekonomik konkurrues në këtë tender nga (dileri) e jo nga prodhuesi, siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit ku tek pjesa Kërkesat mbi mundësitë teknike ose profesionale pika 9.1 dhe 9.2 kërkesa e tretë është caktuar që Operatori Ekonomik i cili tenderon duhet të ofrojë Autorizim për shitje dhe Servisim nga prodhuesi për pajisjen e ofruar. Edhe përkundër kërkesës së vendosur shumë qartë në Dosjen e Tenderit, Komisioni vlerësues e ka shpallur të përgjegjshëm Operatorin në fjalë edhe pse i njëjti nuk ka ofruar Autorizim për shitje dhe servisim nga prodhuesi, por vetëm nga dileri i autorizuar. Komisioni vlerësues duke vepruar në këtë mënyrë ka shkelur kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit.

Në Dosjen e Tenderit dhe Kërkesën e njësisë kërkuuese, që ka përgatitur A.K. për këtë aktivitet të prokurimit, tek pjesa e specifikimeve teknike të detyrueshme, **Agjencia ka vërejtur se specifikimet teknike që janë përpiluar për lot 2 ku është kërkuar Furnizim me Ultrazë-Ultrasound**, autoriteti kontraktues ka përkthyer specifikime teknike të cilat janë favorizuese për një prodhues dhe në të njëjtën kohë specifikimet e tilla mund ti eliminojnë disa prodhues të këtyre

pajisjeve mjekësore. Autoriteti kontraktues ka përshkruar disa specifikime si në vijim: Micro Scan Processing, Compound Imaging, Color Flow Measurement, Electronic Convex Sector, Electronic Linear, Electronic Phased Array Sector, Color: Color Doppler, Power Flow and Directional Power Flow Imaging, TDI, THI(Tissue Harmonic Image), Dual B, Quad Display, B and Doppler, B+Color, Dual B(Flow), Triplex mode: B, Flow, and PW/CW Doppler, Frame Rate: 750 frames/sec or more, Screen Saver, **M-Mode**, Gain:0-255 adjustable, B and B(Flow) Simultaneous Real-time Display, Steer Angle: 5 kinds (linear probe) Max. ± 20 degrees, Sample Volume Size for PË Doppler 1 -20 mm, **M-Mode** Cube Gibson Teichholz. Specifikimet teknike që duhet ti kenë këto pajisje janë specifikuar nga Autoriteti kontraktues në atë mënyrë që i përshtatën prodhuesit *SonoScape* dhe eliminonjë prodhuesit tjerë të këtyre pajisjeve.

Ndërsa lidhur me lot 3 tek pjesa e Specifikimeve teknike të detyrueshme të Dosjes së Tenderit, Agjencia ka vërejtur se **specifikimet teknike që janë përpiluar për lot 3 ku është kërkuar Furnizim me Aparat të anestezionit me gaz monitor dhe monitor të pacientit, Njësia Kërkuese** e Autoritetit Kontraktues ka përshkruar specifikime teknike të cilat gjithashtu e favorizojnë një prodhues dhe në të njëjtën kohë specififikimet e tilla i eliminonjë disa prodhues të këtyre pajisjeve mjekësore. Specifikimet teknike që janë kërkuar për këtë pajisje janë si në vijim: Three large drawers, Power input 100 to 240 VAC,50/60 Hz,70 VA, Operatrion time with fully charged batteries 45 minutes (up to 120 minutes) O2 flush At 87 psi(6) bar: max 75 l/min; at 41 psi (2.8 bar) : min.25 l/min) Integrated safety functions (S-ORC)O2 23% O2/N2O, O2 Flow then o.2 l/min, Volumne Co2 absorber 1.5, Communication interface 1Xrs232 etj. Specifikimet teknike që janë përgatitur nga Autoriteti Kontraktues janë përpiluar në atë mënyrë që i përshtatën prodhuesit *Dräger* duke i eliminuar prodhuesit tjerë të këtyre pajisjeve mjekësore.

Gjatë ekzaminimit të Dosjes së Tenderit dhe Raporteve të vlerësimit të Tenderëve, Agjencia ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues këtë aktivitet të prokurimit e ka ndarë në 5 lote, ndërsa gjatë ekzaminimit dhe krahasimit në mes Dosjes së Tenderit dhe Raportit të vlerësimit të Tenderëve shihet se në Dosjen e Tenderit janë paraparë 5 lote, ndërsa në Raportin e Komisionit vlerësues rreth vlerësimit vërehet se loti 4 është ndarë në lot 4/a dhe lot 4/b ku për të njëjtin lot janë propozuar 2 Operator Ekonomik si fitues të Lotit. Sipas Legjislacionit në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që një aktivitet të prokurimit ta ndajë në lote (pjesë) **në raste të kontratave të përbëra nga një sërë punësh, mallrash ose shërbimesh homogjene që i shërbejnë një qëllimi të njëjtë**, por ndarja e aktivitetit të prokurimit duhet të behët para së të përgatitet Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit dhe se ndarjet e më vonshme nuk janë të lejuara me Ligj, gjithashtu nuk është e lejuar që një lot të ndahet në nën lote. Veprimet e tilla nga ana e Autoritetit Kontraktues bien ndesh me Legjislacionin në fuqi për Prokurimin Publik.

Lidhur me Lot 5 Komisioni vlerësues ka konstatuar se ka vetëm 1 ofertë, andaj në mungesë të dy e më shumë ofertave të përgjegjshme ka rekomanduar anulimin e këtij loti. Agjencia kundër Korrupsionit gjithashtu ka vërejtur edhe disa shkelje tjera të cilat janë bërë gjatë vlerësimit të tenderëve nga ana e Komisionit vlerësues, tek pjesa Kërkesat mbi mundësitë teknike ose profesionale pika 9.1 dhe 9.2 kërkesa e tretë është kërkuar që Operatori Ekonomik i cili tenderon

duhet të ofrojë Autorizim (original) për shitje dhe Servisim nga prodhuesi për pajisjen e ofruar, ndërsa ka pasur raste që Komisioni vlerësues i ka pranuar edhe Autorizimet e skanuara e jo origjinale ashtu siç është kërkuar në Dosjen e Tenderit.

Agjencia Kundër Korrupsionit kërkon nga Njësia Kërkuese e Autoritetit Kontraktues që të ketë kujdes në përgatitjen e Specifikimeve teknike duke mos përcaktuar vlera fikse, por të paraqes minimumin e Specifikimeve teknike në mënyrë që të lejoj konkurrencë të hapur për të gjithë Operatorët ekonomik. Agjencia gjithashtu kërkon edhe nga Komisioni vlerësues dhe Zyrtari Kryesor i Prokurimit që të kenë kujdes që çdo herë gjatë vlerësimit të Tenderëve të bëhet vlerësimi në pajtueshmëri të plotë me kërkesat e vendosura në Dosjen e Tenderit e jo të ketë devijime nga Dosja e Tenderit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues të cekura më lartë, konsiderojmë se bien ndesh me Nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 27 Dosja e Tenderit, nenin 28 Specifikimet teknike dhe nenin 59 Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i Tenderëve të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, dhe me Nenin 2 Kalkulimi i vlerës së parashikuar të Kontratës Publike i Rregullores për Prokurimin Publik.

.Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti kontraktues që t'i shmang praktikatat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !